



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 7
Prishtinë, më 15.1.2018, në orën 9:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Sërgjan Mitrovic dhe Zafir Berisha.

Pjesëmarrësit e tjerë: Artan Murati, KDI; Vlora Nushi, OPA/UNMIK; Blerta Bejtullahu, Edita Kusari, Shaban Murturi EUSR/EU Office; Sanije Berisha, OSBE; Adem Gashi, USEP; Steve Banks, Emma Lomax, U.S. Embassy; Hajrudin Skenderi, Swiss Embassy dhe media.

Nga zyra e komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-028 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Vjosa Osmani-Sadriu, lidhur me shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-028 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, tha se jemi në një situatë ku kemi një raport preliminar, kemi informata se janë duke u bërë hetimet për pretendime sa u përket hartave, ka argumente të reja rreth kontrollit efektiv në një pjesë të kontestuar të territorit dhe materiale të reja, të cilat ende zyrtarisht nuk u janë dorëzuar deputetëve të tjerë, pos anëtarëve të këtij komisioni. Ajo propozoi që projektligji të procedohet pa ndonjë rekomandim për miratim apo mosmiratim, pasi që një precedent i tillë ka ndodhur edhe më parë në disa komisione të Kuvendit.

Zafir Berisha, theksoi se kjo çështje është shqyrtuar më tepër se që duhet dhe është vërtetuar nga komisioni i ri qeveritar se marrëveshja është ndërtuar mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara dhe se ka pasur tejkallim të kompetencave. Propozoj që Komisioni t'i rekomandojë Kuvendit që të mos e miratojë këtë projektligj në seancë.

Visar Ymeri, tha se e përkrahë propozimin që komisioni të votojë rekomandimin për mosmiratim të Projektligjit nr. 06/L-028 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës

së Kosovës dhe Malit të Zi në Kuvend. Si Komision FunkSIONAL, Ymeri tha se kemi qenë më shumë të informuar nga Komisioni Shtetëror dhe se e ka të qartë për disa shkelje të cilat janë gjetur.

Doruntinë Maloku-Kastrati, për shkak të rëndësisë së madhe që ka ky projektligj, propozoi që të procedohet pa ndonjë rekomandim. Në kohën kur prokuroria është duke i hetuar pretendimet e Komisionit të kryesuar nga z. Bulliqi, tha se ndoshta do të ishte ndonjë ndërhyrje nëse do të rekomandonim për apo kundër miratimit të këtij projektligji.

Time Kadrijaj, tha se i përkrahë deputetët Berisha e Ymeri se për këtë projektligj është bërë një kohë e gjatë që gjendet në shqyrtim dhe propozoi që komisioni ti rekomandojë Kuvendit që Projektligji nr. 06/L-028 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, të mos miratohet.

Elmi Reçica, theksoi se do të ishte mirë që të votoheshin rekomandimet për ta mbështetur demarkacionin me Malin e Zi, mirëpo, meqë nuk kemi pajtueshmëri sa i përket kësaj çështje do të duhej që propozimi i znj. Maloku, të shkojë në Kryesi dhe pastaj në seancë plenare të vendoset.

Danush Ademi, në lidhje me shkeljet rreth projektligjit, theksoi se komisioni nuk duhet ta luaj rolin e prokurorisë dhe propozoi që projektligji përmes Kryesisë ti përcillet Kuvendit që deputetët ta thonë fjalën e tyre.

Aida Dërguti, për projektligjin tha se do të ishte mirë që të kemi një rekomandim të komisionit, pasi që kemi edhe qëndrim për të. Pavarësisht gjetjeve të reja e dyshimeve dhe tejkalimit të kompetencave të Komisionit shtetëror, Dërguti propozoi që të jepet në votim propozimi i deputetit Zafir Berisha, dhe më pas të përcillet projektligji për shqyrtim në seancë.

Vjosa Osmani-Sadriu, përkrahu diskutimin e deputetes Maloku. Ajo theksoi se rekomandimi për projektligjin do të duhej të përcillej nga Komisioni në Kryesi, ku do të caktohet radhitja për seancë plenare e këtij projektligji me rekomandim vetëm për shqyrtim të tij. Një rast i tillë ka ndodhur edhe në lidhje me Gjykatën Speciale, me ç'rast ishte përcjellë raporti për seancë plenare pa ndonjë rekomandim. Kryetarja e komisionit e dha në votim propozimin që Projektligjit nr. 06/L-028 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi të procedohet pa ndonjë rekomandim.

Me rastin e votimit të pranishëm në mbledhje ishin të gjithë anëtarët e Komisionit, nga të cilët pesë anëtarë përkrahën propozimin ndërsa pesë anëtarët e tjerë ishin kundër këtij propozimi, ndërsa një anëtar nuk votoi.

Aida Dërguti, theksoi se është shumë problematike që të procedohet për seancë një çështje që është shumë problematike dhe që është duke u hetuar.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se pajtohet me mendimin e znj. Dërguti, prandaj duhet njoftuar që kjo është arsyeja që projektligji nuk po procedohet për t'u votuar apo mos votuar në seancë plenare.

Visar Ymeri, tha se raporti nga prof. Bulliqi nuk ka të bëjë vetëm me dyshimet e ngritura për falsifikim dokumentesh dhe nuk mund të reduktohet vetëm me këtë fakt, sepse ka edhe fakte të reja të cilat tregojnë se marrëveshja nuk është në rregull. Është e rëndësishme që të konstatohet nga Kuvendi tejkalimi i kompetencave të Komisionit Shtetëror, fakt të cilin nuk e ka konstatuar Qeveria e të cilin duhet ta korrigjojë Kuvendi. Ky është një nga konstatimet që nxirret nga raporti i Komisionit të udhëhequr nga z. Bulliqi, i cili duhet të konstatohet me kërkesën për mosratifikim të marrëveshjes.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se nuk ka për synim që ta reduktojë materien e paraqitur nga Komisioni i ri shtetëror vetëm në çështjen e hetimeve. Çështja e hartave nuk është krejtësisht teknike, dhe lidhet me argumentin e kontrollit efektiv edhe me argumente të shumta të reja që ende nuk janë paraqitur zyrtarisht.

Zafir Berisha, theksoi se kundërshtimi ynë nuk ka të bëjë me gjetjet e fundit të Komisionit të ri edhe gjetjet për falsifikim të dokumenteve veçanërisht hartave, por ka të bëjë qysh në fillim dhe është shumë thelbësor. Hetimet nuk mund të japin ndonjë rezultat për të qenë përcaktues se si do të votojnë deputetët. Ai tha se Kuvendi përmes një dokumenti apo rezolute mund ta njoftojë Parlamentin e Malit të Zi se Komisioni qeveritar ka tejkaluar kompetencat dhe se jemi të bindur se demarkimi me Malin e Zi, ka qenë gabim dhe dëmton territorin e Kosovës.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha meqenëse komisioni është i ndarë për mënyrën e procedimit të këtij projektligji, propozoi që të shkohet pa rekomandim konkret dhe në seancë të deklarohen. Personalisht tha se do të deklarohem edhe si kryetare e Komisionit për zhvillimet që i ka pasur Komisioni, por edhe si deputete dhe secili prej nesh do ta ketë mundësinë të deklarohet, meqenëse kemi informata pak më të hollësishme se sa deputetët e tjerë.

Elmi Reçica, theksoi se çdo projektligj, çdo raport i agjencive të cilat i përgjigjën Kuvendit duhet të shqyrtohen dhe të vendosen në seancë plenare. Është e domosdoshme që qytetarët të njoftohen drejtpërsëdrejti për qëndrimet, për faktet, për argumentet dhe pastaj të vendoset. Projektligji tha se duhet të procedohet në seancë plenare.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se detyrë e komisionit është që ta kthejë projektligjin në Kryesi, pastaj në koordinim në mes të partive politike të përfaqësuara në Kuvend dhe që janë të përfaqësuara në Kryesi të Kuvendit të vendoset për datën e shqyrtimit të tij në seancë plenare.

Visar Ymeri, tha se propozimi i shtruar nga deputeti Zafir Berisha, nuk ka të bëjë fare me idenë që ne si komision ta kthejmë këtë marrëveshje, por t'i rekomandojmë seancës të mos e ratifikojë marrëveshjen për shkak të këtyre arsyeve që janë përmendur. Ai ritheksoi se konstatimet për tejkalim të kompetencave nga Komisioni Shtetëror dhe aplikimi i kriterit kadastral, i cili nuk është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare publike, janë dy argumente që bëjnë të qartë për secilin deputet se ky projektligj nuk do të duhej të miratohet.

Doruntinë Maloku-Kastrati, në diskutimin e saj shtoi se është obligim i komisionit dhe i secilit deputet që mos të votojë asnjë materie që është gjysmake dhe çfarëdo vote për miratim ose jo do të ishte votim i një materie të papërfunduar. Ajo propozoi që të mos debatohet tutje kjo çështje në komision, por të ecet tutje.

Evgjeni Thaçi-Dragusha, propozoi që komisioni mos të futet prapë në shqyrtim të kësaj çështjeje që është duke u bërë vite me radhë, por të vazhdojë me procedimin e saj.

Time Kadrijaj, tha se ne e kemi kundërshtuar edhe pa këtë raport të ri të Komisionit Shtetëror marrëveshjen dhe se ky raport e ka plotësuar tek ne atë dyshim se Kosova humb territor me këtë marrëveshje. Prandaj, nuk duhet spekuluar se raporti është gjysmak dhe se e prish tërësinë, ngase të gjithë kemi pasur qëndrimet tona lidhur me të edhe përpara këtij raporti.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se nuk ka ndodhur ndonjëherë që në Kuvend të votohet për apo kundër një marrëveshjeje, përderisa raportet rreth tyre janë preliminare. Sa i përket argumenteve të së drejtës ndërkombëtare, ajo rekomandoi që të shikohen traktatet dhe se çfarë thonë vendimet e gjyqësore e të tribunaleve, para se të shikohen librat e viteve të 60-ta dhe gojëdhënat. Lidhur me këtë ajo tha se Kosova ka detyrim ndërkombëtar, sepse ka marrë përsipër që sipas Deklaratës së Pavarësisë dhe Kushtetues t'i zbatojë traktatet e konventat ndërkombëtare, në përputhje me parimin e suksedimit. Znj. Osmani-Sadriu, njoftoi se së fundi është marrë një vendim në rastin e Sllovenisë dhe Kroacisë, ku thuhet se kur ka përputhshmëri të të dhënave kadastrale, atëherë ato merren si kriter. Në takim me Komisionin Shtetëror, tha se kërkua përgjigje në lidhje me atë se, a i posedon Mali i Zi të dhënat kadastrale deri në pikën ku përcaktohet nga kjo marrëveshje dhe asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje. Ajo po ashtu tha se Qeveria i ka fshirë një serë materialesh nga ueb faqja e saj, që kanë të bëjnë me këtë çështje. Znj. Komisioni Shtetëror është duke punuar që ta sjellin raportin përfundimtar para se të vendoset kjo çështje në seancë dhe propozoi, meqë votat ishin të barabarta t'i dërgohet Kryesisë rekomandimi për shqyrtim duke i përmendur disa prej argumenteve që u shqyrtuan këtu.

Aida Dërguti, theksoi se kriteri i kadastrës nuk ka vlejtur me rastin e demarkimit të kufirit me Maqedoninë, ku edhe ka pasur prona të qytetarëve tanë atje, ndërsa tani përdoren standarde të dyfishta me Malin i Zi, që nuk është në rregull, ngase ka materiale se është ushtruar kontrolli efektiv në atë pikë kufitare. Dërguti tha se kemi dy raporte të cilat na ndihmojnë të përcaktohem për vendimin tonë lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji.

Vjosa Osmani-Sadriu, theksoi se sa i përket rastit të Maqedonisë, pakoja e Ahtisaarit ka paraparë që të vlejë marrëveshja e nënshkruar në vitin 2001, në mes të Jugosllavisë së atëhershme dhe Maqedonisë, kurse për të gjithë fqinjët tjerë sa i përket kufijve të Kosovës është përcaktuar që të vlejë kufijtë administrativ që kanë qenë në fuqi deri në vitin 1988. Ajo shtoi se me rastin e Maqedonisë është bërë vetëm demarkimi, vendosja e gurëve dhe se nuk ka pasur shqyrtim dhe vendosje të kufirit. Prona private, tha se nuk lidhet me çështjen e kufijve shtetëror, sepse ka raste kur qytetarët me marrëveshje dypalëshe me shtetin tjetër merren vesh që ta shfrytëzojnë, siç ka ndodh me rastin në Debëllde.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë,

P e r f u n d i m

Projektligjit nr. 06/L-028 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, të procedohet në Kuvend për shqyrtim.

Vjosa Osmani-Sadriu, njoftoi anëtarët e Komisionit se më se dy muaj është duke u ftuar për raportim në komision, ministri i MPJ-së, Behgjet Pacolli, porse nuk ka përgjigje pozitive në ftesën e komisionit. Ajo njoftoi se i është përsëritur sërish ftesa për të raportuar në komision gjatë kësaj jave dhe e fton atë që ta marrë seriozisht ofertën e bërë për bashkëpunim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja Komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu